



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P-12
Prishtinë, më 5 shkurt 2015,

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 5 SHKURT 2015**

Seancën e drejtoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi Xhavit HALITI, nënkryetar.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare, të caktuar nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Kryetari i njoftoi deputetët se me kërkesë të kryetarit të Kuvendit e me vendim të Presidentes së Republikës së Kosovës, është bërë zëvendësimi i deputetit z. Jakup Krasniqi, pas dorëheqjes së tij, me deputetin z. Enver Hoti, nga subjekti politik “Nisma për Kosovën” .

Ai i dëshiroi deputetit të ri mirëseardhje dhe punë të mbarë në Kuvend dhe e ftoi që ta nënshkruajë tekstin e betimit.

Deputeti z. Enver Hoti e nënshkroi tekstin e Betimit.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Rustem Mustafa, Nuredin Ibishi, Aida Dërguti, Melihate Tërmkolli, Duda Balje, Valdete Bajrami, Shaip Muja, Arben Gashi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu, Zafir Berisha, Fikrim Damka, Blerta Deliu-Kodra, Vjosa Osmani, Alma Lama, Bekim Haxhiu, Haxhi Shala, Ganimete Musliu dhe Shejtim Bulliqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti, Ismajl Kurteshi, parashtroi pyetje për zv/kryeministrin, Branimir Stojanoviq, në lidhje me atë se si zv/kryeministër në Qeverinë e Republikës së Kosovës, në të cilën pozitë është nga 9 dhjetori 2014, a e njeh pavarësinë e Republikës së Kosovës.

Zv/kryeministri Branimir Stojanoviq nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Daut Haradinaj parashtroi pyetje për ministrin Haki Demolli në lidhje me kohën e procedimit në Kuvend të Projektligjit për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës.

Ministri Haki Demolli nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Daut Haradinaj, në pyetjen e parashtruar për ministrin Skender Hyseni, e cila ka shifrën DO-124, të 9 janarit 2015, tha se ministri është deklaruar që do të japë përgjigjen me shkrim.

Deputeti Bekim Haxhiu parashtroi pyetje për ministrin Imet Rrahmani në lidhje me numrin e ndërhyrjeve kirurgjike në Klinikën e Kirurgjisë Vaskulare gjatë viteve 2011, 2012, 2013 dhe 2014. Sa ndërhyrje kirurgjike janë bërë prej hapjes së Klinikës së Kardiokirurgjisë, sa mjete janë investuar në të dhe sa pacientë për këto shërbime janë trajtuar jashtë institucioneve publike të financuara nga Ministria e Shëndetësisë?

Sa koronografi janë kryer, sa stenda dhe sa pejsmekerë janë vendosur në Klinikën e Kardiologjisë, përkatësisht në Kardiologjinë Invazive gjatë viteve 2011, 2012, 2013 dhe 2014 dhe sa mjete janë shpenzuar për ofrimin e këtyre shërbimeve për pacientë jashtë institucioneve publike.

Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj pyetjes së deputetit Bekim Haxhiu.

Deputeti Bekim Haxhiu parashtroi pyetje për ministrin Imet Rrahmani në lidhje me atë se në cilin institucion të licencuar nga MSH-ja, qytetarët mund t'i marrin shërbimet e kujdesit tretësor shëndetësor, pasi që institucioni i licencuar - QKUK-ja është shuar, ndërsa Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës është organ menaxhues, nuk është klinikë dhe nuk ka licencë për operim si klinikë terciare.

Ku mbeti QKUK-ja, nëse ekziston kush është menaxhmenti i saj?

Nëse nuk ekziston, kush e ka shuar dhe në bazë të cilit ligj?

Kur pritet që qytetarët e komunave Prishtinë, Podujevë, Obiliq, Fushë-Kosovë, Lipjan dhe Drenas ta kenë të organizuar shërbimin e kujdesit dytësor?

Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj pyetjes së deputetit Bekim Haxhiu.

Deputetja Xhevahire Izmaku parashtroi pyetje për ministrin Arban Abrashi në lidhje me numrin e familjeve në nevojë të cilave u ndalet ndihma sociale në momentin kur fëmija i mbush 5 vjet, pra në kohën kur nevojat në familje nuk zvogëlohen, por përkundrazi ato rriten. Një familje në nevojë nuk duhet të privohet nga ndihma sociale në momentin kur fëmija i mbush 5 vjet, dhe është mirë të punohet në evitim të këtij kriteri.

Ministri Arban Abrashi iu përgjigj pyetjes së deputetes Xhevahire Izmaku.

Deputetja Xhevahire Izmaku parashtroi pyetje për ministrin Arban Abrashi në lidhje me atë se çka mund të pritet nga ministria që ai drejton lidhur me realizimin e projekteve për punësimet sezonale dhe si bëhet selektimi i komunave pjesëmarrëse në ato projekte.

Ministri Arban Abrashi iu përgjigj pyetjes së deputetes Xhevahire Izmaku.

Deputetja Alma Lama parashtoi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me fazën e punimeve për realizimin e projektit dhe kur do të vendoset në lokacionin e caktuar Memoriali “Heroinat”, i cili u kushtohet kontributit të grave dhënë gjatë luftës së fundit në Kosovë. Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputetja Albulena Haxhiu parashtoi pyetje për ministrin Hajredin Kuçi në lidhje me humbjet dhe veprimet e ndërmarra, që sipas raportit të Auditorit të Përgjithshëm, Administrata Publike në përgjithësi, shumicën e lëndëve gjyqësore i ka të humbura në procedurat gjyqësore ku si palë e paditur janë institucionet publike. Ministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Albulena Haxhiu parashtoi pyetje për ministrin Hajredin Kuçi në lidhje me harmonizimin e legjislacionit për funksionalizimin e Gjykatës Speciale. Ministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Vjosa Osmani parashtoi pyetje për ministrin Imet Rrahmani në lidhje me atë se a ka bërë Ministria që ai drejton koordinimin e nevojshëm për anëtarësim në OBSH. A është ngritur ndonjë komision ndërminstor i cili do të merrej me anëtarësimin në OBSH dhe nëse po cilat institucione janë përfshirë aty? Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj pyetjes së deputetes Vjosa Osmani.

Deputetja Aida Dërguti parashtoi pyetje për kryeministrin Isa Mustafa në lidhje me atë se a ka marrëveshje të fshehtë lidhur me, siç tha ajo, se sipas deklaratave të liderit të Listës serbe, se Asociacioni i Komunave Serbe do të jetë me kompetenca ekzekutive dhe se për këtë është në dijeni edhe koalicioni qeveritar PDK-LDK. Ministri Arban Abrashi iu përgjigj pyetjes së deputetes Aida Dërguti. Ai tha se këtë e bën me autorizim të kryeministrit Isa Mustafa.

Deputetja Aida Dërguti parashtoi pyetje për ministrin Skënder Hyseni në lidhje me atë se çka keni ndërmarrë dhe a kanë nisur hetimet, për veprimet, siç tha ajo të paligjshme të policisë, të përdorimit të gazit lotsjellës dhe plumbave të gomës si dhe shtënien në ajër të një polici, në protestën e mbajtur më 27 janar 2015, në Sheshin “Nëna Terezë”, në Prishtinë. Ministri Skënder Hyseni iu përgjigj pyetjes së deputetes Aida Dërguti.

* * *

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
4. Interpelanca e Kryeministrit Isa Mustafa sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të AAK-së, për përgjegjësinë e ministrit Aleksandër Jabllanoviq për deklaratat e tij publike,
5. Projektrezoluta për pengimin e migrimit ilegal të qytetarëve të Kosovës,
6. Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media,
7. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për emërimin e anëtarit në Komisionin parlamentar,
8. Propozimi i Grupit Parlamentar të Listës Serbe për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin parlamentar.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Kuvendi miratoi procesverbalet e seancave plenare të mbajtur më 19 janar 2015, në orën 10:00, 19 janar 2015, në orën 20:00, dhe 23 janar 2015, e vazhduar më 26 janar 2015, pa asnjë vërejtje.

Deputetja Albulena Haxhiu pati vërejtje në procesverbalin e seancës së jashtëzakonshme të mbajtur më 19 janar 2015, në orën 17:00.

Procesverbali i plotësuar i seancës së jashtëzakonshme të mbajtur më 19 janar 2015, në orën 17:00, do të procedohet për miratim në seancën plenare të 12 shkurtit 2015.

4. Interpelanca e kryeministrit Isa Mustafa, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të AAK-së, për përgjegjësinë e ministrit Aleksandër Jablanoviq për deklaratat e tij publike

Kryetari e ftoi kryetaren e Grupi Parlamentar të AAK-së që ta marrë fjalën.

Donika Kadaj-Bujupi tha se Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e përkrahur nga partitë tjera opozitare, më 19 janar 2015, ka dorëzuar kërkesën për interpelancë për një çështje të vetme që ishte rekomandim i nënave gjakovare dhe qytetarëve të tjerë të vendit tonë, të cilët u ndien të fyer nga një cilësim shovinist të cilin e dëgjuam shumë herë nga një regjim i errët, i gjatë, i cili me dekada na cilësoi si egërsira.

Ajo, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës dhe deputetëve të tjerë të opozitës i shtroi këto pyetje:

E para, pse Kryeministri Mustafa nuk është këtu sot?

Pse nuk e kemi tekstin e arsyetimit?

Në cilën mbledhje të Qeverisë e keni marrë këtë vendim, dhe ju ftoj që në Kuvend të na e sillni vendimin e nënshkruar dhe të protokolluar që të sigurohemi se për çka bëhet fjalë.

Dhe, krejt për fund, po besoj që shkarkimi i këtij ministrit ka qenë një mësim për ministrat tjerë, por duhet të jetë mësim edhe për krejt Qeverinë dhe me theks të veçantë për kryeministrin, i cili nëse vazhdon t'i injorojë deputetët, Kuvendin dhe popullin, sigurisht që në protestat e radhës do të ketë thirrje për shkarkime të tjera. Fjalimi i plotë është dhënë në transkript.

Në vazhdim, kryetari hapi diskutimin.

Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, fillimisht tha se pret që GP i AAK-së ta tërheqë kërkesën për interpelancë, sepse nuk ka objekt për diskutim, e rrjedhimisht nuk duhet të ketë debat.

Ne, normalisht e përkrahim vendimin e kryeministrit për të shkarkuar z. Jablanoviq, dhe kryeministri i ka zbatuar të drejtat dhe përgjegjësitë e tij kushtetuese me rastin e marrjes së vendimit të tillë.

Arsyet pse sot zoti Mustafa nuk është këtu qëndrojnë në faktin se kjo pikë nuk është në rend të ditës ose s' duhet të jetë në rend të ditës, sepse ajo që ishte kërkesë për thirrjen në interpelancë, është realizuar.

Kryeministri i vendit çdo kohë shkarkon dhe emëron ministra, zëvendësministra dhe asnjëherë nuk e ka obligim ta sjellë me shkrim.

Në lidhje me këtë çështje u deklaruan deputetët: Elmi Reçica, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Zafir Berisha, në emër të Grupit Parlamentar NISMA, Qerim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Emilija Rexhepi, Donika Kadaj-Bujupi, Shaip Muja, Danush Ademi dhe Duda Balje, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi, Xhavit Haliti, më pas e caktoi një pauzë.

* * *

Pas pauzës, deputeti Daut Haradinaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, e tërhoqi kërkesën për interpelancë me kryeministrin Isa Mustafa.

5. Projekt-rezoluta për pengimin e migrimit ilegal të qytetarëve të Kosovës

Kryetari tha se diskutimet lidhur me debatin për pengimin e migrimit ilegal të qytetarëve të Kosovës kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 26 janar 2015.

Në ndërkohë, deputetja Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, e ka dërguar në Administratë tekstin e harmonizuar të Projektrezolutës.

Teksti i Projektrezolutës është harmonizuar me GP të PDK-së, GP të LDK-së, GP të VV-së, dhe GP “Nisma”.

Donika Kadaj-Bujupi, kryetare e Grupit Parlamentar të AAK-së, ia paraqiti Kuvendit tekstin e Projektrezolutës së harmonizuar.

Në lidhje me këtë çështje u deklaruan deputetët: Elmi Reçica, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Enver Hoti, në emër të Grupit Parlamentar NISMA, Qerim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Emilija Rexhepi, Donika Kadaj-Bujupi, Shaip Muja, Danush Ademi dhe Duda Balje, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari e hodhi në votim Projektrezolutën e paraqitur nga deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

Të pranishëm në sallë ishin 73 deputetë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 69,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se:

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 52, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, pas debatit të zhvilluar për pengimin e migrimit ilegal të qytetarëve të Kosovës, në seancën plenare të mbajtur më 26 janar 2015, si dhe harmonizimit të tekstit të rezolutës me grupet parlamentare: GP të PDK-së, GP të LDK-së, GP VV dhe GP Nisma, nxori këtë:

R E Z O L U T Ë

PËR PENGIMIN E MIGRIMIT ILEGAL TË QYTETARËVE TË KOSOVËS

Angazhim më i madh i Qeverisë së Republikës së Kosovës në zhvillimin ekonomik, me theks të veçantë në shtimin e vendeve të reja të punës për qytetarët e Kosovës;

Krijimi i fondit për pengimin e migrimit ilegal;

Ndryshimi i politikave fiskale në përputhshmëri të plotë me kërkesat e kamotshme të bizneseve dhe lirimi i lëndës së parë nga taksa doganore dhe pagesa e brendshme e TVSH-së, e jo në kufi, ende pa filluar përpunimi i mallit, ashtu që të rritet konkurrenca e prodhimeve vendore kundrejt atyre të importuara, me ç'rast do të shtohen vendet e punës;

Krijimi i menjëhershëm i lehtësirave doganore në përputhshmëri me rekomandimet e Komisionit Evropian të datës 22 tetor 2014 nga RAPORTI FINAL në Përkrahje për Bordin e Pavarur të Kosovës për Shqyrtime në fushën e doganave dhe akcizave;

Të anulohet menjëherë udhëzimi administrativ (QRK) nr. 04/2014 për përcaktimin e kostos së shpenzimeve të transportit të mallrave të importuara, i cili udhëzim është në kundërshtim të plotë me ekonominë e tregut;

Krijimi i menjëhershëm i lehtësirave doganore, tatimore dhe administrative për të gjithë ata të cilët hapin më tepër se 10 vende të reja të punës;

Lirimi nga taksa dhe nga TVSH-ja e të gjitha makinerive apo pajisjeve dhe pjesëve rezervë, të cilat janë të dedikuara për prodhim ose përpunim të ndryshëm në Kosovë;

Lirimi nga taksa doganore i kompjuterëve, POS terminaleve (point of sale), pajisjeve dhe arkave fiskale, ashtu që shkollat dhe bizneset të mund të pajisen me këto pajisje që të ngritët efektshmëria në studim dhe punë;

Subvencione reale, jo vetëm fjalë elektorale për të gjithë prodhuesit vendorë, ose të interesuarit për të hapur biznese të reja në agrikulturë;

Angazhimi i Qeverisë dhe Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale për arritjen e marrëveshjeve me shtetet e Evropës për punësim sezonal të qytetarëve tanë;

Raportim në çdo tre muaj në komisionet parlamentare nga ministrat përkatës;

Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia të obligohen të jenë aktive dhe të veprojnë në ndalimin e rrjeteve kriminale të trafikimit;

Gjyqësori t'i zgjidhë rastet e trafikimeve në procedurë të përsheptuar;

Ministria e Integrimit Evropian ta intensifikojë fushatën vetëdijesuese rreth informimit të qytetarëve lidhur me migrimin ilegal, kërkimin e azilit dhe mundësitë e marrjes së vizave;

Qeveria të punojë në plotësimin e kushteve për liberalizimin e vizave, si mjet për pamundësimin e funksionimit të rrjetit të trafikantëve;

Qeveria të angazhohet për krijimin e kushteve dhe lehtësirave për biznese, si dhe për hapjen e vendeve të reja të punës në Kosovë dhe marrëveshjet ndërshtetërore për punësim nëpërmjet migrimit të kontrolluar legal të fuqisë së kualifikuar punëtore;

Të vazhdojë procesin e riatdhesimit të koordinuar me shtetet, në të cilat kanë emigruar qytetarët e Kosovës.

6. Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media

Kryetari kërkoi nga deputetët që të deklarohen me votim lidhur me propozimin e grupeve parlamentare për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media.

Të pranishëm në sallë ishin 76 deputetë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 74,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media, në këtë përbërje:

1. Xhevahire Izmaqi, nga GP i PDK-së, kryesuese,
2. Shqipe Pantina, nga GP i LVV-së, zv/kryesuese e parë,
3. Kujtim Paçak, nga GP "6+", zv/kryesues i dytë,
4. Blerta Deliu, nga GP i PDK-së, anëtare,
5. Sadri Ferati, nga GP i LDK-së, anëtar,
6. Alma Lama, nga GP i LDK-së, anëtare,
7. Pal Lekaj, nga GP i AAK-së, anëtar,
8. _____ nga GP i LS-së, anëtar/e,
9. Enver Hoti, nga GP "Nisma për Kosovën", anëtar.

II. Ngarkohet Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media që të veprojë në përputhje me nenin 11, paragrafi 2.3 i Ligjit nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur për Media dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

7. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje" për emërimin e anëtarit në komisionin parlamentar

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje" e ka propozuar deputetin Rexhep Selimi anëtar në Komisionin parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, bazuar në Vendimin Nr. 05-V-005, të Seancës Plenare, të mbajtur më 18 dhjetor 2015.

Ai kërkoi nga deputetët që nëpërmjet një votimi formal, me ngritje dore, të deklarohen për propozimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje".

Të pranishëm në sallë ishin 62 deputetë.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e mori këtë:

V E N D I M

1. Deputeti Rexhep Selimi emërohet anëtar i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

8. Propozimi i Grupit Parlamentar të Listës serbe për zëvendësimin e anëtarit në komisionin parlamentar

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar Lista serbe e ka propozuar deputetin Slavko Simiq zëvendëskryesues të dytë, në Komisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, në vend të deputetes Jasmina Zhivković.

Ai kërkoi nga deputetët që nëpërmjet një votimi formal, me ngritje dore, të deklarohen për propozimin e Grupit Parlamentar Lista serbe.

Të pranishëm në sallë ishin 50 deputetë.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk e ka kuorumin e mjaftueshëm për të proceduar me votim për këtë pikë të rendit të ditës.

Kryetari konstatoi se kjo pikë shtyhet për seancën plenare të radhës.

* * *

Kryetari i mbylli punimet e seancës së sotme në orën 15:25.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale